

PROF. ASOC. DR. ETHEM ÇEKU

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
ethem.cekuni@uni-pr.edu

**NDIKIMI I ÇLIRIMIT NË IDENTITETIN KOMBËTAR:
ANALIZA SHKENCORE DHE PERSPEKTIVA
PËR TË ARDHMEN**

Abstrakt:

Ky artikull ndërmerr një analizë të thelluar dhe ndërdisiplinore mbi rolin formues të luftërave çlirimtare në procesin e ndërtimit dhe konsolidimit të identitetit kombëtar shqiptar, duke u mbështetur në historiografinë kritike, teoritë moderne të nacionalizmit dhe konceptet e kujtesës kolektive. Duke kaluar nga një lexim përcaktues i historisë drejt një qasjeje kritike, studimi ndriçon mënyrën se si çlirimi – i përjetuar në epoka me rëndësi të veçantë, si ajo e Skënderbeut, Lidhjes së Prizrenit, Luftës Nacionalçlirimtare dhe Luftës për çlirimin e Kosovës – ka funksionuar si një akt themelor i artikullimit të ndërgjegjes kombëtare dhe i mobilizimit të përkatësisë etnike.

Nëpërmjet analizës së transformimit të përvojave çlirimtare në narrativa kombformuese, artikulli shqyrton se si shteti dhe institucionet historiografike, në kontekste të ndryshme kohore dhe ideologjike, i kanë strukturuar këto ngjarje si përbërës të legjitimitetit politik dhe identitar. Duke ndjekur një qasje krahasuese dhe diskursive që përfshin burime primare dhe literaturë sekondare kritike, studimi synon të kontribuojë në rikonceptimin e funksionit të luftës dhe të çlirimit si mekanizma simbolikë për ndërtimin e kujtesës kolektive dhe të kohezionit kombëtar.

Në këtë kontekst, çlirimi nuk paraqitet thjesht si përfundim i një pushtimi të huaj, por si një proces historik me pasoja afatgjata në formësimin e kulturës politike shqiptare dhe në artikullimin e një etosi kombëtar, i cili ka mbijetuar përtej rrethanave të veçanta të kohës. Artikulli thekson se narrativa e çlirimit, megjithëse shpeshherë e politizuar, mbetet një burim i pashtershëm për kuptimin e identitetit dhe të projektit të sovranitetit kombëtar në hapësirën shqiptare bashkëkohore.

Fjalë kyç:

Identiteti kombëtar shqiptar, luftërat çlirimtare, kujtesa historike, historiografia shqiptare, nacionalizmi modern, procesi i kombformimit, shtetndërtimi në Kosovë.

H y r j e

Në studimet bashkëkohore për identitetin kombëtar, një rol të veçantë zë analiza e luftërave çlirimtare si faktorë ndikues në ndërtimin e vetëdijes kolektive. Ky punim trajton çlirimin jo vetëm si proces politik-ushtarak, por edhe si komponent kulturor dhe simbolik, i cili ka shërbyer për të konsoliduar identitetin kombëtar shqiptar përgjatë shekujve. Përmes një qasjeje ndërdisiplinore, që përfshin historiografinë kritike, teoritë moderne të nacionalizmit dhe konceptin e kujtesës kolektive, synohet të rikonsiderohet se si ngjarjet me rëndësi të veçantë të çlirimit janë përjetuar, përfaqësuar dhe përdorur në narrativat zyrtare e popullore për të ushqyer ndjenjat e përkatësisë kombëtare.

Në vend që të trajtohen si momente të izoluara historike, këto ngjarje analizohen si procese të vazhdueshme, të cilat kanë ndikuar në formësimin e diskursit publik dhe të vetëdijes kombëtare, duke pasur ndikim afatgjatë në kulturën politike shqiptare. Ky trajtim ndjek një qasje krahasuese ndërmjet përvojës së shqiptarëve në Shqipëri më 1912 dhe të shqiptarëve në Kosovë më 1944, për të identifikuar ngjashmëritë dhe dallimet në mënyrën si përjetohet liria, çlirimi dhe ndërtimi i kombit.

Objektivat e studimit përfshijnë analizën e rolit të shtetit, edukimit dhe historiografisë në strukturimin e kujtesës çlirimtare dhe në vendosjen e një identiteti të institucionalizuar. Duke lidhur përvojat e ndryshme të shqiptarëve në hapësira të ndryshme gjeografike, artikulli synon të evidentojë se si çlirimi është konceptualizuar si një akt themelor që riformëson marrëdhënien midis individit dhe kombit.

Metodologjia ndërthur analizën historike me atë diskursive dhe kulturore, duke u mbështetur në burime primare dhe literaturë shkencore kritike. Kjo lejon një qasje të thelluar ndaj mënyrës se si ngjarjet historike projektohen në ndërgjegjen kombëtare dhe ndikimin që ato kanë pasur në përforcimin e solidaritetit dhe kohezionit kombëtar, si në kohë paqeje, ashtu edhe në periudha krize.

Ideja e “kombit” nuk mund të përdoret për të legjitimuar çdo lloj lufte, por vetëm në mënyrë të kufizuar dhe specifike, kur bëhet fjalë për luftë mbrojtëse brenda territorit të vet, pas një pushtimi të jashtëm. Në këtë kuptim, lufta bëhet një akt i domosdoshëm për vetëmbijetesën dhe ruajtjen e identitetit kombëtar. Raste të tilla, si rezistenca ruse ndaj Napoleonit dhe Hitlerit, ose qëndresa e popullit vietnamez kundër SHBA-së, janë dëshmi të fuqisë mobilizuese që ushtron një kërcënim ekzistencial mbi një komb të pushtuar.¹ Në epokën e nacionalizmit modern, luftërat janë interpretuar shpesh si prova e vitalitetit të kombit – aftësia për të frymëzuar sakrificë dhe qëndresë heroike në emër të një identiteti të përbashkët.² Në këtë kuadër, Hobsbawm shprehet në mënyrë kritike se për formimin e kombit, “kriteri i tretë ishte aftësia e provuar për pushtim.” Ai thekson se “për ta bërë një popullsi të vetëdijshme për ekzistencën e vet kolektive, nuk ka gjë më të fortë se sa të qenit një popull perandorak... për shekullin e nëntëmbëdhjetë, pushtimi përbënte provën darviniane të suksesit evolucionar si specie shoqërore”.³

Në themel të konflikteve etnike qëndrojnë dallimet strukturore dhe historike, të cilat, nga njëra anë, shkaktojnë frikë nga diskriminimi, asimilimi apo dhuna dhe, nga ana tjetër, ushqejnë dëshirën për ‘çlirim’, e cila manifestohet në formën e autonomisë ose, në rastin ideal, të pavarësisë.⁴ Kjo dëshirë është veçanërisht e theksuar në kontekste ku identiteti kolektiv është kërcënuar nga aktorë shtetërorë dominues. Ashtu siç kombet janë përfaqësuar shpesh si produkte të proceseve historike të dhunshme,⁵ edhe shumë shtete bashkëkohore kanë lindur si rezultat i drejtpërdrejtë të luftërave për pavarësi.⁶

¹ Max Haller, “War and National Identity”, *Polemos* 6, no. 1-2 (2003): 107; Eric J. Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780* (Tiranë: Toena, 2012), 67-68.

² John Hutchinson, “Bringing the study of Warfare into theories of nationalism”, *Nations and Nationalism* 24, no. 1 (2017): 11.

³ Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi*, 68; Kwame Anthony Appiah, “Rëndësia e vendit tjetër, në mbrojtje të kozmopolizmit”, në *AIS Annual Publication* (Tiranë: AIS, 2019), 35.

⁴ Јелена Вукоичић, “Рат и национални идентитет”, *Политеиа* бр. 3, Бања Лука, јун 2012 (Јелена Вукоичић, “Rat i nacionalni identitet”, *Politeia* br. 3, Banja Luka, jun 2012), 180.

⁵ Anthony D. Smith, *Nationalism and Modernism, A critical survey of recent theories of nations and nationalism* (London and New York: Routledge, 1998), 8.

⁶ Вукоичић, *Rat i nacionalni identitet*, 195; John G. Stoessinger, *Përse kombet shkojnë në luftë* (Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, 2015), 7.

Lufta, me efektet e saj intensive dhe transformuese, ka shërbyer si një katalizator për ndryshime të mëdha shoqërore dhe politike. Nëpërmjet ushtrimit të dhunës së centralizuar dhe selektive, ajo ka funksionuar si një mekanizëm riorganizues në përzgjedhjen historike të qytetërimeve.⁷ Shpeshherë rezultatet e luftës kanë prodhuar konfigurime të reja politike, duke ngulitur vlera dhe simbole kombëtare në strukturën shoqërore. Fitorja është përjetuar si konfirmim i legjitimitetit të elitave dhe i vizionit të tyre për kombin, ndërsa disfata është interpretuar si dështim i karakterit të kombit ose i klasës drejtuese.⁸ Rasti i Francës ilustron qartë se si luftërat kanë ushqyer përplasjet ideologjike ndërmjet republikanëve, bonapartistëve dhe tradicionalistëve katolikë, duke ndikuar drejtpërdrejt në ndërtimin e narrativave të nacionalizmit francez.⁹ Figurat historike si Joana D'Arc (Zhan D'Ark) janë rikontekstualizuar nga grupime të ndryshme ideologjike: për republikanët, ajo mishëronte frymën demokratike dhe liridashëse, ndërsa për konservatorët, ajo ishte simboli i qytetërimit katolik evropian.¹⁰

Lufta mbetet një ndër aktet më të fuqishme për të krijuar histori dhe për të gjeneruar identifikim kolektiv. Ajo ka një funksion të dyfishtë: si agjente ndryshimi dhe si bartëse e kujtesës. “Karakterit i shenjtë” i disa luftërave historike u ka dhënë atyre një fuqi lidhëse dhe emocionale që formëson identitete. Përveç traumës dhe sakrificës, ato kanë prodhuar një ndjenjë borxhi historik, e cila ndihmon në krijimin e bashkësive simbolike përtej kohës dhe hapësirës.¹¹ Në këtë mënyrë, lufta ka shërbyer si element përforcues në ndërtimin e vetimazhit etnik dhe kombëtar, duke ndihmuar në kristalizimin e stereotipeve ne/ata përmes propagandës dhe narrativave kolektive.¹²

Kultura historike kombëtare është një rrjet lidhës ndërbreznor, i cili, përmes ngjarjeve dhe figurave themelore, ndërton vazhdimësinë simbolike të një kombi. Ajo reflekton marrëdhëniet ndërmjet brezave,

⁷ *Po aty*, 196.

⁸ John Horne, “Defeat and Memory in Modern History”, in J. Macleod (ed.) *Defeat and Memory: Cultural Histories of Military Defeat in the Modern Era* (New York: Palgrave Macmillan, 2008), 16-17.

⁹ John Hutchinson, “Nations as Zones of Conflict”, *Nations and Nationalism* 12 (2004) 10.1111/j. 1469-8129.2006.002453.x.

¹⁰ Hutchinson, “Bringing the study of warfare into theories of nationalism”, 16.

¹¹ Vukoičić, *Rat i nacionalni identitet*, 189.

¹² *Po aty*, 196.

formëson zakonet dhe karakterin kolektiv, si dhe përforcon idenë e një bote të strukturuar në kombe të veçanta.¹³

Lufta dhe çlirimi kombëtar si faktorë që forcojnë identitetin kombëtar

Narrativa klasike e ndërtimit të kombit shpesh bazohet mbi histori që përshkruajnë formimin dhe afirmimin e një shteti-komb si pasqyrim i karakterit kombëtar, vlerave të lirisë, shtetësisë dhe përparimit.¹⁴ Në këtë kuadër, historia e kombit shqiptar është ndërthurur ngushtësisht me epoka lufte dhe rezistence, të cilat kanë prodhuar ngjarje kulmore në kujtesën kombëtare: krijimi i formacioneve të para shtetërore, si shteti arbër, pashallëqet e Shkodrës e Janinës, Lidhja e Prizrenit, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe, më pas, ajo e Kosovës. Koncepti i çlirimit këtu kuptohet si rezultat i një procesi të gjatë rezistence, në të cilin përpjekja e shqiptarëve për liri ka qenë e vazhdueshme, pavarësisht pushtimeve të njëpasnjëshme.¹⁵

Pozicioni gjeostrategjik i territoreve shqiptare në shekuj i ka bërë ato një zonë të përhershme përplasjesh të interesave perandorakë dhe ballkanikë. Pas rënies së zotërimeve bizantine në Itali (1071), Shqipëria u shndërrua në një kufi të ndjeshëm të Perandorisë Bizantine, me pasojë të rënda për stabilitetin e saj. Shekujt XII-XIII shënuan krijimin e shteteve të reja në Ballkan – Rashës, Bullgarisë dhe Epirit – që e intensifikuan rivalitetin mbi tokat shqiptare. Më pas, ardhja e osmanëve shënoi fillimin e një rezistence që zgjati mbi pesë shekuj dhe u karakterizua nga lëvizje të herëpashershme për çlirim dhe vetëqeverisje. Për pasojë, breza të tërë shqiptarësh jetuan në kushte lufte, u përballën me represion por gjithashtu njohën fitore dhe mundësinë për të projektuar një subjektivitet politik të tyrin. Kjo kulmoi me krijimin e entiteteve, si Principata e Arbrit, shteti i

¹³ Anthony D. S. Smith, *Nationalism in the Twentieth Century* (New York: New York University Press, 1979), 3

¹⁴ Mark Bevir, "National Histories: Prospects for Critique and Narrative", *Journal of the Philosophy of History* 1/2 (2007), <https://escholarship.org/uc/item/8vp2925p>

¹⁵ Ismail Qemali: "Memorandum sent to Lord Edward Grey", *Discourses of collective identity in Central and Southeast Europe (1770-1945): Texts and commentaries*, vol. 3/1, Modernism: The Creation of Nation States, Edited by Ahmet Ersoy, Maciej Górny and Vangelis Kechriotis (Budapest, New York: Central European University Press 2010), 238.

Skënderbeut, Lidhja e Prizrenit, shteti shqiptar i vitit 1912 dhe, pas një rrugëtimi të gjatë historik, Republika e Kosovës.¹⁶ Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912, pason përpjekjet e rilindësve dhe të Lidhjes së Prizrenit për të përmbushur idealin e Skënderbeut.¹⁷ Në prag të rënies së sundimit osman në Ballkan, elita kombëtare shqiptare artikuloi synimin për ndarjen përfundimtare nga Perandoria Osmane dhe për shmangien e copëtimit të territoreve shqiptare. Akti i shpalljes së Pavarësisë u konsiderua si arritja më e madhe e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.¹⁸

Në fund të shek. XX, shqiptarët në Kosovë, Maqedoni dhe Kosovën Lindore ndërmorën një rezistencë të armatosur për të afirmuar të drejtat e tyre kombëtare, rezistencë e cila çoi në krijimin e shtetit të Kosovës dhe statusit shtetformues në Maqedoni.¹⁹ Këto ngjarje zënë vend në kujtesën kolektive si momente identitare që kanë ndihmuar në forcimin e vetëdijes kombëtare.

Lufta, në këtë kontekst, nuk është vetëm përplasje fizike, por është edhe një proces përmes të cilit mobilizohet komuniteti dhe krijohet ndjenja e bashkësisë përballë rrezikut. Kjo gjeneron emocione të dyfishta – rezistencë ndaj të huajit dhe solidaritet brenda grupit – duke e shndërruar identitetin kombëtar dhe konfliktin në fenomene të ndërvarura.²⁰ Rindërtimi i historisë kombëtare përmes figurave dhe ngjarjeve ikonike ndihmon në ripërforcimin e ndjenjës së përkatësisë, siç

¹⁶ Marenglen Verli, “Nga Lidhja e Prizrenit te pavarësia e Kosovës”, *Studime historike*, nr. 3-4 (2007): 166; Enis Sulstarova, *Nacionalizmi: Kombi, shteti dhe politika në epokën moderne* (Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2022), 197-238.

¹⁷ Artemida Kabashi, *The Memory of George Castriota-Scanderbeg among the Arbëresh of Italy. A Study on the role of the Diaspora in the Creation of Albanian National Identity* (A Thesis in History, Texas Tech University, 2005), 84; Kristaq Prifti, “Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te pavarësia e Shqipërisë dhe e Kosovës”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2008): 145.

¹⁸ Kristaq Prifti, *Shkrime historike për Rilindjen Kombëtare* (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2016), 544; Antonina Zhelyazkova, *Albania and the Albanian Identities* (Sofia: IMIR, 2000), 9-63.

¹⁹ Mihail Kogălniceanu, “Speech for the opening of the course on national history”, *Discourses of collective identity in Central and Southeast Europe (1770-1945): texts and commentaries*, Vol. II, National Romanticism – The Formation of National Movements, edited by Balázs Trencsényi and Michal Kopecek (Budapest, New York: Central European University Press, 2007), 44.

²⁰ Vukoičić, *Rat i nacionalni identitet*, 178.

shprehet Kadareja: kombi duhet të kujtojë lavdinë, jo vetëm dhimbjen, për të mbajtur lidhjen shpirtërore me atdheun.²¹

Lëvizjet çlirimtare të shqiptarëve dhe roli i tyre në forcimin e identitetit kombëtar

Gjatë pesë shekujve të sundimit osman, popujt e Ballkanit, përfshirë shqiptarët, mbetën pa një histori të dokumentuar e të përjetuar nga vetë ata. Për këta popuj, koha dukej sikur kishte ngrirë, dhe e vetmja dritare për ndërtimin e vetëdijes historike ishte rikthimi në periudhën para ardhjes së osmanëve, në Mesjetë, madje edhe më herët në kohë.²² Ndryshe nga popujt e tjerë ballkanikë, shqiptarëve nuk iu desh të shpiknin një hero kombëtar si Vilhelm Teli,²³ sepse ata kishin Gjergj Kastrioti Skënderbeun – një figurë historike autentike, e mbështetur në burime të pasura dokumentare dhe në një traditë të fuqishme gojore. Autorët kombëtaristë të shek. XIX i dhanë kësaj figure një kuptim të ri kombëtar, duke e shndërruar në simbol të unitetit dhe rezistencës shqiptare.²⁴ Historiografia shqiptare e trajtoi Skënderbeun si figurën unifikuese të shqiptarëve, duke e paraqitur si një hero të gjithëve: si një Gjergj të krishterë – herë katolik, herë ortodoks – por edhe si një Skënderbe mysliman, emblemë e shqiptarit universal, të cilin Rilindja Kombëtare dhe Pashko Vasa e ngritën në figurë të përbashkët identitare.²⁵ Sipas Barletit, “Skënderbeu nuk është vetëm një hero madhështor, por edhe shpëtimtar i atdheut të vet”.²⁶ Çlirimi i hapësirave të gjera në Shqipërinë Qendrore dhe të Epërme nga ushtria arbërore e Skënderbeut, përfaqëson kulmin e një lufte të ashpër dhe të gjerë të

²¹ Piro Misha, *Arratisja nga burgjet e historisë. Çdo të thotë të jesh shqiptar* (Tiranë: Toena, 2008), 42.

²² *Po aty*, 61.

²³ Sulstarova, *Nacionalizmi: Kombi, shteti*, 198.

²⁴ Misha, *Arratisja nga burgjet e historisë*, 42.

²⁵ Skënder Asani, “Skënderbeu i ri, një interpretim ndryshe”, *Studime albanologjike* 17 (2018): 7.

²⁶ Minna Skafte Jensen, “Një rrëfënjë heroike: Skënderbeu i Marin Barletit midis krijimtarisë gojore dhe letërsisë”, <http://scanderbeg.dk/Barleti.pdf> (shikuar më 20 qershor 2025).

shqiptarëve kundër Perandorisë Osmane, e cila do të shënonte edhe një kthesë vendimtare në historinë e tyre politike.²⁷

Emri i Skënderbeut mbijetoi edhe në periudhat më të errëta të pushtimit osman, duke u ruajtur si simbol i shpresës dhe i qëndresës. Në korrik të vitit 1577, kur himarjotët i dorëzuan Papa Gregorit XIII një projekt kundër Perandorisë Osmane, ata i referoheshin Skënderbeut si mbret i tyre.²⁸ Në tetor të vitit 1658, në relacionin drejtuar Kongregacionit të Propagandës së Fesë, imzot Pjetër Bogdani, ipeshkëv i Shkodrës, shpreh shpresën e ringjalljes së një figure të re të tillë: “Një Skënderbe i ri”.²⁹ Në shek. XIX, figura e Skënderbeut mori një dimension të ri përmes veprës së intelektualëve si Jeronim de Rada, Zef Skura, Zef Serembe, Dora D’Istria, vëllezërit Frashëri, Ismail Qemali, Fan Noli e të tjerë, të cilët jetuan dhe punuan jashtë trojeve shqiptare. Ata filluan të ndërtonin historinë shqiptare me Skënderbeun në qendër, duke e shndërruar atë në simbol të lëvizjes për pavarësi nga Perandoria Osmane.³⁰ Lavdia e figurës së Skënderbeut u bë objekt i kërkimeve të shumta akademike dhe historike, të cilat, në rrjedhën e shekujve, e pozicionuan atë si përfaqësuesin e “Epokës së Madhe të Arbanonit”, duke e quajtur “Dragoi i Ballkanit”.³¹ Miti i epokës së tij u bë shtylla mitike e kombit shqiptar: në përfytyrimin e rilindësve, Skënderbeu përfaqësonte gjenium shqiptar, luftëtarin e lirisë, mbrojtësin e së mirës përballë së keqes.

²⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Iirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet ’20 të shek. XIX), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2002), 348.

²⁸ Vitalien Laurent, “La république de la Chimère et ses appels au pape Grégoire XIII (1577-1582)”, in *Revue des études sud-est européennes* 51 (2013): 27-44; Peter Bartl, *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie und osmanischem Reich. Zur Türkenkriegs-problematik an der Wende vom 16. zum 17. Jahrhundert* (Wiesbaden: Otto Harrassowitz Verlag, 1974). Për komente shih: Konstantinos Giakoumis, “Self-Identification by Himarriots, 16 th to 19 th Centuries”, in *Erytheia. Revista de estudios bizantinos y neogriegos* 37 (2016): 205-246.

²⁹ Pjetër Bogdani, *Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*, (ed.) Odette Marquet (Shkodër: At Gjergj Fishta, 1997), 11, 17, 23, 84 (no. 29).

³⁰ Kabashi, *The Memory of George Castriota-Scanderbeg*, 28.

³¹ Edlira Dhima, “Skanderbeg, An emblem in the World Literature”, *European Scientific Journal* January 9, nr. 2 (2013): 164.

Figura e tij ishte e përshtatshme për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare për disa arsye: *së pari*, ai rikujtonte ekzistencën e një shteti mesjetar shqiptar; *së dyti*, rrëzonte mitin se shqiptarët nuk kishin kapacitete shtetformuese; *së treti*, si princ i krishterë, ai dëshmonte se shqiptarët i kishin vlerat etnike përmbi ato fetare; *së katërti*, figura e tij dallonte qartësisht Lëvizjen Kombëtare Shqiptare nga lëvizjet panislamiste në pjesët e tjera të Perandorisë Osmane.³² Luftërat e tij nuk ishin thjesht betejat e një princi kundër një perandorie, por zhvillonin një filozofi të çlirimit dhe vetëdijes kombëtare përballë një pushtimi të projektuar në dëm të identitetit shqiptar.

Ndonëse në historiografinë turke Skënderbeu shpesh paraqitet si një pengesë për pushtimin e Shqipërisë dhe si faktor ndalues i zgjerimit osman drejt Europës, ka raste kur ai vlerësohet për disa nga cilësitë e tij. Lavdërimet më të spikatura dhe më bujare ndaj tij gjenden në historinë zyrtare të Perandorisë Osmane, shkruar nga autori Uzunçarili.³³ Një ndër historiografët e shquar të historisë së Republikës Turke, Reshad Ekrem Koçu (Reşad Ekrem Koçu), në monografinë e tij për Sulltan Mehmetin II, e përshkruan Skënderbeun si një nga dy armiqtë më të fuqishëm të sulltanit, krahas Huniadit. Këtë admirim të nënkuptuar e thekson më tej kur deklaron se “sundimtari i Shqipërisë, Skënderbeu, ishte aleati më i vlefshëm i Venedikut dhe ai që lodhi më së shumti osmanët, duke u shkakuar vështirësitë më të mëdha në Ballkan.”³⁴

Gjatë lëvizjes së tij në trojet arbërore, Skënderbeu arriti t'i vetëdijësonte fiset shqiptare të Mesjetës për përkatësinë e tyre etnike, duke i nxitur drejt bashkëpunimit dhe unitetit. Ky proces homogjenizimi shërbeu si themel për ndërtimin e një identiteti kombëtar shqiptar, i cili do të konsolidohej më vonë. Për më tepër, ky veprim ishte një mesazh i qartë për shqiptarët e Ballkanit: vetëm përmes bashkimit të interesave dhe paqes me fqinjët, mund të ndërtohej një komb i qëndrueshëm dhe prosperues.³⁵ Krijimi i shtetit mesjetar shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut përfaqësonte hapin më të rëndësishëm drejt bashkimit

³² Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar* (Tiranë: Koha, 1998), 82.

³³ Bülent Bilmez, “Skanderbeg in the Turkish Historiography: An attempt towards a critical assessment”, *The Living Skanderbeg – The Albanian Hero between Myth and History*, (ed.) Monica Genesin, Joachim Matzinger & Giancarlo Vallone (Hamburg: Verlag Dr. Kovač, 2010), 205.

³⁴ *Po aty*, 206. Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu* (Tiranë: Fjala: 2014), 81.

³⁵ *Po aty*.

politik të shqiptarëve në atë kohë, edhe pse nuk përfshinte të gjitha trevat etnike.³⁶

Në fillim të shek. XIX, Pashallëku i Shkodrës dhe ai i Janinës do të shndërroheshin në simbole të përpjekjeve për shkëputje nga Perandoria Osmane. Këto dy njësi politike vendosën bazën e nacionalizmit shqiptar në zhvillim. Ali Pashë Tepelena dhe Kara Mahmut Pasha u angazhuan për krijimin e shteteve autonome me karakter feudal, duke ndjekur idealin e çlirimit dhe të pavarësisë nga sundimi osman.³⁷

Në shek. XIX politika e Perandorisë Osmane ndaj çështjes kombëtare shqiptare u përqendrua në përpjekjet për të tjetërsuar elementin kombëtar dhe për ta zëvendësuar atë me identitetin fetar. Nëse analizohen shkollat turke dhe ato të huaja, të hapura në katër vilajetet shqiptare, del në pah strategjia asimiluese e qeverisë osmane, e cila synonte të pengonte zhvillimin e ndjenjës kombëtare shqiptare. “Një përzierje rrethanash tipike shqiptare dhe një politikë e pamenduar osmane bëri që ndjenja kombëtare shqiptare të mbetej e varrosur deri në fund të shekullit XIX. Nëpërmjet metodës së kulaçit dhe kërbaçit, autoritetet turke mënjanuan nacionalizmin shqiptar për një kohë të gjatë, me anë të represionit të ashpër dhe me anë të ryshfetit”.³⁸

Përballë kësaj politike, filluan të merrnin formë lëvizje të shumta politike, kulturore, iluministe dhe letrare, të cilat shënuan një kthesë vendimtare në zgjimin e vetëdijes kombëtare. Që nga viti 1836, me botimin e “Milosao-s” nga De Rada dhe të Qarkores së Veqilharxhit po atë vit, zgjimi i ndjenjës etnike, gjuhësore dhe arsimore përfshi u të gjitha shtresat intelektuale e sociale, pa dallim feje apo krahine. Kjo lëvizje, përmes armës më të fuqishme – arsimit në gjuhën shqipe – letërsisë së angazhuar dhe veprimit politik tronditi ndërgjegjen e fjetur, duke mobilizuar shqiptarët drejt një qëllimi të përbashkët: sendërtimin e idealit kombëtar dhe çlirimin nga pushtuesi shekullor.³⁹

Si kundërpërgjigje ndaj marrëveshjes së Shën Stefanit dhe në prag të Kongresit të Berlinit, më 10 qershor 1878, u themelua Lidhja e Prizrenit, e konceptuar si një vazhdim i natyrshëm i Lidhjes së Lezhës së

³⁶ Lulëzim Lajçi, “The National – Albanian and Stateforming dimension of Gjergj Kastrioti-Skënderbeg”, *Studia Albanica* 1 (2019): 180.

³⁷ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, 610- 672.

³⁸ Misha, *Arratisja nga burgjet e historisë*, 42.

³⁹ Mahmud Hysa, *Alamida Shqiptare II*, Studime dhe recensione (Shkup: Logos A, 2000), 6.

Skënderbeut.⁴⁰ Edhe pse shumica e delegatëve vinin nga Kosova dhe Maqedonia Perëndimore, në Lidhje morën pjesë edhe delegatë nga Jugu i Shqipërisë, si dhe pesë delegatë të besimeve të krishtera – ortodoksë dhe katolikë.⁴¹ Më vonë, përfaqësimi u zgjerua me 26 delegatë nga vilajeti i Shkodrës dhe 20 nga ai i Janinës, duke e bërë Lidhjen më përfaqësuese.⁴³ Pjesëmarrësit deklaruan se: “Ne, në Lidhjen tonë, vendosëm që, para së gjithash, të provojmë që pa diskutuar për fenë, jemi shqiptarë”. Ky bashkim mbifetar, sipas Süleyman Külçe-s (Sylejman Kyllçe), ishte ‘një vepër zgjimi e madhe’, e cila simbolizoi konsolidimin e ndjenjës kombëtare shqiptare.⁴⁴

Lidhja Shqiptare e Prizrenit u paraqiti Fuqive të Mëdha një memorandum, ku kërkonte bashkimin e të gjitha territoreve shqiptare në një provincë brenda Perandorisë Osmane, e pajisur me një asamble të zgjedhur nga vetë shqiptarët dhe të drejtuar nga një guvernator turk, me seli në qytetin e Manastirit. Ky memorandum kishte një rëndësi të madhe, pasi u nënshkrua në emër të të gjithë shqiptarëve dhe jashtë strukturave zyrtare të Perandorisë Osmane.⁴⁵ Për më tepër, dy peticione të tjera të hartuara nga Lidhja – një për Kongresin e Berlinit dhe një për Portën e Lartë – u nënshkruan nga afro 4 000 veta, myslimanë e të krishterë së bashku, çka dëshmon për një përfshirje të gjerë kombëtare në mbrojtje të atdheut.⁴⁶ Në këtë frymë bashkimi, Lidhja përvetësoi programin kombëtar të Rilindjes Shqiptare dhe nisi betejën për njohjen e kombit shqiptar si një entitet unik dhe i pandashëm për respektimin e parimit të kombësisë, ruajtjen e tërësisë territoriale dhe për bashkimin e këtyre

⁴⁰ Zhelyazkova, *Albania and the Albanian Identities*, 9-63.

⁴¹ Miranda Vickers, *The Albanians – A Modern History* (London: I. B. Tauris Publishers, 1999), 30.

⁴² Gazmend Shpuza, “Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në xhaminë Bajrak (15 qershor 1878)”, *Univers*, revistë shkencore dhe kulturore, Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, Nr.11 (2009): 38.

⁴³ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet ’30 të shek. XIX-1912), redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë (Tiranë: Toena, 2002), 158-160.

⁴⁴ Shpuza, “Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, 39.

⁴⁵ Tara Ashley O’Brien, *Manufacturing homogeneity in the Modern Albanian Nation* (Dissertation), (Budapest: Central European University Budapest, 2008), 30.

⁴⁶ Kristo Frashëri, *Lidhja e Prizrenit 1878-1881* (Tiranë: Akademia e Shkencave, 2012), 184.

territoreve në një njësi të vetme shtetërore.⁴⁷ Programi autonomist i miratuar në Kuvendin themelues të Lidhjes së Prizrenit përbënte bazën e një projektkushtetute të mundshme për Shqipërinë autonome, duke parashikuar një atdhe të përbashkët për një popull që fliste të njëjtën gjuhë.⁴⁸ Një ndër vendimet më të rëndësishme të Kuvendit, siç pasqyrohet edhe në shtypin e kohës, ishte miratimi i barazisë politike dhe juridike për të gjithë shqiptarët, pavarësisht përkatësisë së tyre fetare.⁴⁹

Sipas studiuesit turk Kemal Karpat, Lidhja e Prizrenit përbën fillimin e nacionalizmit dhe të aspiratës për pavarësi të shqiptarëve.⁵⁰ Ajo u bë mburoja e parë ndaj tendencave ekspansioniste të shteteve fqinje dhe bashkoi elementët nacionalistë shqiptarë rreth kërkesave për autonomi kulturore dhe administrative brenda perandorisë. Megjithatë, paaftësia e shtetit osman për të mbrojtur interesat e shqiptarëve përballë presioneve ndërkombëtare e shtyu udhëheqjen e Lidhjes drejt aspiratave për autonomi të plotë.⁵¹ Veprimtaria e Lidhjes nuk u kufizua vetëm në diplomaci, por përfshiu edhe aksione të armatosura: ndër to përmenden aksioni i Gjakovës, betejat për mbrojtjen e Plavës dhe të Gucisë gjatë dimrit të viteve 1879-1880, mbrojtja e Hotit dhe e Grudës në prill 1880, si dhe ajo e Ulqinit në vjeshtën e po atij viti.⁵²

Krijimi i Lidhjes së Prizrenit dhe veprimtaria e saj gjatë viteve 1880-1881 shënuan një kthesë të rëndësishme në rritjen e ndjenjës nacionaliste shqiptare dhe në konsolidimin e ndërgjegjes kombëtare.⁵³ Ajo hyri në historinë bashkëkohore si një organizim gjithëkombëtar që

⁴⁷ Noel Malcolm, *Kosovo, A Short History* (London: Pan Books, 2002), 223; Gazmend Shpuza, *Në vazhdën e gjurmimeve...* (Tiranë: Toena, 1997) 50.

⁴⁸ Shpuza, “Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”, 44; Prifti, “Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te pavarësia”, 139.

⁴⁹ Kristo Frashëri, “Lidhja e Prizrenit dhe çështja kombëtare”, *Studime historike*, nr. 1-2 (1998): 184.

⁵⁰ Kemal Karpat, *Politizimi i Islamit: Rindërtimi i identitetit, i shtetit, i fesë dhe i komunitetit në Shtetin Osman të vonshëm, përktheu Urim Poshka* (Tiranë: Alsar, 2016), 168.

⁵¹ Miranda Vickers, *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo* (New York: Columbia University Press, 1998), 45.

⁵² Thoma Murzaku, “Traktati i Shën Stefanit dhe rrjedhat e zbatimit të tij për shqiptarët”, *Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*, vëll. I, (red.) Aleks Buda, K. Frashëri, A. Kostallari (Tiranë: Akademia e Shkencave, 1979), 202.

⁵³ Nuray Bozborra, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane* (Tiranë: Dituria, 2002), 16.

aspironte shkëputjen nga Perandoria Osmane, krijimin e një shteti kombëtar dhe vendosjen e shqiptarëve në rrugën e progresit politik, ekonomik e kulturor, me synimin për të zënë vendin që u takonte në familjen e shteteve të qytetëruara të Europës.⁵⁴ Lidhja e Prizrenit arriti të krijonte një ndjenjë të fortë identiteti dhe uniteti mes shqiptarëve. Përplasjet me Portën e Lartë e thelluan më tej këtë identitet të pavarur.⁵⁵ Ndikimi i saj ishte thelbësor për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe mbetet i ndjeshëm deri në ditët e sotme.

Pavarësisht njohjes së Shqipërisë si një shtet-komb legjitim nga Fuqitë e Mëdha, përpjekjet për transformimin e vendit nga një grupim i shpërndarë klanesh në një komb të bashkuar mbetën një sfidë madhore për elitën shqiptare. Siç shprehej Mit'hat Frashëri, qëllimi ishte që Shqipëria të kalonte nga një fragmentarizëm social e krahinor në një bashkësi të vetëdijshme kombëtare.⁵⁶ Dekadat e para të pavarësisë së vendit u karakterizuan nga pasiguri politike dhe rotacione të shpeshta të qeverive, duke penguar kështu krijimin e një ndjenje të qëndrueshme kohezioni dhe uniteti kombëtar.⁵⁷

Nacionalizmi modern shqiptar, sipas historianit Bernd Fischer, është një fenomen i shek. XX dhe kontributet më të rëndësishme në këtë drejtim i atribuohen Mbretit Zog, i cili, gjatë sundimit të tij (1928-1939), e institucionalizoi për herë të parë këtë ide në politikën shtetërore.⁵⁸ Përkundër dëshirës së elitës për konsolidimin e identitetit kombëtar, progresi në këtë drejtim ishte i ngadalshëm, dhe vetëm gjatë një periudhe stabiliteti relativ prej pesëmbëdhjetë vjetësh nën qeverisjen e Ahmet Zogut u vunë themelet e shtetit modern.⁵⁹ Megjithatë, në krahasim me zhvillimet e ngjashme në shtetet europiane dhe ballkanike, procesi shqiptar i formimit të shtetit kombëtar ishte i vonuar. Në periudhën mes Dy Luftërave Botërore u ndërmorën hapa konkretë në drejtim të

⁵⁴ Frashëri, "Lidhja e Prizrenit 1878-1881", 200.

⁵⁵ Edona Llukacaj, "That "Other" Identity: The Identity Crisis in the Albania of Today", *International Journal of the Humanities* 7 (2009): 13-20. 10.18848/1447-9508/CGP/v06i09/42530. 224.

⁵⁶ David Sebastian Fermor, *Heritage and national identity in post-socialist Albania*. Doctoral thesis (PhD) (Manchester Metropolitan University, 2008), 79.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ Denis Vuka, *Ideology and Educational Media: Albania's Third Grade National History Textbooks during the Period of Self-Isolation (1978-1984)*, (temë disertacioni) (Freien Universität Berlin: 2018), 11.

⁵⁹ Fermor, *Heritage and national identity*, 79-80.

homogjenizimit kulturor dhe social të vendit.⁶⁰ Gjatë kësaj kohe, tematika historike e orientuar drejt sakrificës, heroizmit dhe vetëdijes kombëtare mori trajtim të thelluar, me theks të veçantë mbi figurën e Skënderbeut dhe Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.⁶¹

Megjithatë, periudha e Luftës së Dytë Botërore mbetet ende e pazbuluar plotësisht nga historiografia shqiptare. Kjo jo vetëm për motive akademike, por edhe për shkak të nevojës së vazhdueshme për t'u ballafaquar me narrativat historike të fqinjëve dhe me interpretimet politike të së kaluarës.⁶² Angazhimi masiv i shqiptarëve në koalicionin antifashist nuk e përjashtonte ekzistencën e dallimeve gjeografike dhe sociale në përfshirjen në këtë lëvizje, duke qenë më e dobët në Veri dhe më e vonuar në Kosovë, krahasuar me Jugun e Shqipërisë.⁶³ Sot është e vështirë të thuhet nëse përfshirja në këtë koalicion ishte një vendim i qëllimshëm apo rezultat i rrethanave.⁶⁴ Megjithatë, Lufta Nacionalçlirimtare mbetet një burim frymëzimi moral për edukimin e brezave dhe një kriter për qëndrimin e dinjitetshëm në arenën ndërkombëtare.⁶⁵

Përvoja e Luftës së Dytë Botërore ndikoi si në forcimin, ashtu edhe në minimin e ndërgjegjes kombëtare. Krijimi i “Shqipërisë së Madhe” nën pushtimin italian, duke përfshirë territore të Kosovës dhe Maqedonisë, solli një entuziazëm të nacionalizmit të përforcuar negativisht, por komprometoi shumë liderë të paraluftës për shkak të bashkëpunimit me pushtuesit.⁶⁶

Në kohën e regjimit komunist, historiografia shqiptare gjeti përkrashje te figurat e periudhave të mëparshme kombëtare, si Skënderbeu dhe Lidhja e Prizrenit, duke krijuar atë që studiues të ndryshëm e kanë

⁶⁰ Misha, *Arratisja nga burgjet e historisë*, 86.

⁶¹ Dritan Egro, “Nacionalizmi shqiptar si fenomen historiografik”, *Studime historike*, nr. 1-2 (2008): 153-154.

⁶² Marenglen Verli, “Antifashizmi, alternativa e perspektivës për kombin shqiptar”, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Instituti i Historisë – Tiranë 2014), 82-83.

⁶³ Verli, “Antifashizmi, alternativa e perspektivës”, 88-89.

⁶⁴ Po aty, 91.

⁶⁵ Kristaq Xharo, “Kombi, lufta, dhe dilemat e fuqisë – Refleksion në 75 vjetorin e Çlirimit”, *Studime për historinë ushtarake*, vëll. 12, nr. 1 (2019): 117.

⁶⁶ Bernd Fischer, *The Development of Albanian Nationalism*, <https://www.wilsoncenter.org/event/the-development-albanian-nationalism> (shikuar më 20 qershor 2025).

përshkruar si nacional-komunizëm. Edhe pse komunizmi synonte universalizmin ideologjik, në Shqipëri, ashtu si në raste të ngjashme me Rumaninë e Çausheskut, ai u bashkua ngushtësisht me ndërtimin e një identiteti kombëtar të fortë.⁶⁷

Siç dihet, komunistët e fituan pushtetin në Shqipëri në fund të Luftës së Dytë Botërore, pasi mundën kundërshtarët e tyre të brendshëm, të cilët përfaqësonin kryesisht pjesën konservatore të shoqërisë shqiptare që synonte të ruante të pandryshuar gjendjen e Shqipërisë së paraluftës.⁶⁸ Shqipëria komuniste ndërtoi një infrastrukturë moderne për të nxitur identitetin kombëtar, duke e paraqitur fitoren komuniste si rrugën kryesore për mbrojtjen e shqiptarizmit. Në këtë përpjekje, u përfshinë edhe elementë të mëhershëm historikë, sidomos ata që sugjerorin vazhdimësinë e luftës për mbrojtjen e vlerave kombëtare – nga betejat e shek. XV kundër Perandorisë Osmane, deri te fitorja në Luftën e Dytë Botërore përmes luftës partizane.

Nëse lëvizjet populliste-komuniste përfituan nga dobësitë dhe joefikasiteti i regjimeve nacionaliste paraardhëse, ato gjithashtu u detyruan të pranonin dhe të shfrytëzonin fuqinë e vazhdueshme të ndjenjave nacionaliste.⁶⁹ Efekti shtesë i faktorëve të ndryshëm që kanë formësuar të kaluarën e Shqipërisë ishte theksimi i pavarësisë dhe i sovranitetit si domosdoshmëri dhe si hap drejt ndërtimit të një shteti modern shqiptar. Pasi morën pushtetin, komunistët filluan të hartonin një politikë aktive të ideologjisë kombëtare, të fokusuar në formimin e një komuniteti të unifikuar kombëtar përmes një kodi të përbashkët kombëtar, i cili duhej të siguronte kontrollin shtetëror mbi shoqërinë.⁷⁰ Periudha komuniste solli një fazë modernizimi që u shoqërua me një rritje të interesit për shkencat humane dhe sociale. Përveç disiplinave tradicionale, si historia dhe gjeografia, kjo periudhë vuri në pah edhe

⁶⁷ Kostas Giakoumis & Ilir Kalemaj, “Aleks Buda, Mitet komuniste rreth kombit dhe struktura konceptuale e Muzeut Historik Kombëtar”, *Aleks Buda dhe studimet albanologjike*. Përmbledhje e materialeve të konferencës shkencore ndërkombëtare, Elbasan, 20 maj 2016 (Tirana: Shpresa Print, 2017), 146.

⁶⁸ Misha, *Arratisja nga burgjet e historisë*, 97.

⁶⁹ Smith, *Nationalism in the Twentieth Century*, 3.

⁷⁰ Nirvana Shkëlzeni, “How and why is a Theory of ideology of importance for media representations of National Identity: Albanian Identity during the Communist Regime”, *Mediterranean Journal of Social Sciences*, vol. 5 no. 2 (January 2014), MCSER Publishing, Rome-Italy, 292-293.

degë të reja si etnografia, folkloristika, studimi i kulturës popullore dhe arkeologjia, të cilat shërbyen për të forcuar identitetin kombëtar.

Në rajonin tonë, luftërat e viteve 1990, trashëgimia e periudhës komuniste dhe plagët e pambyllura të Luftës së Dytë Botërore (duke përfshirë pushtimin, bashkëpunimin dhe pasojat e tyre) përbëjnë ende një fushë të debatueshme dhe të kontestuar, si në rrafshin kombëtar, ashtu edhe në atë rajonal. Aktualisht, ky tension po kulmon me përpjekjet për të glorifikuar kriminelët e luftës, për të zbehur vlerat antifashiste në diskursin publik dhe për të rehabilituar figurat e regjimeve apo të lëvizjeve fashiste dhe kolaboracioniste të periudhës së Luftës së Dytë Botërore.⁷¹ Në këtë kontekst, historiografia franceze e sheh çlirimin si një pikënisje të vetëdijshme për një epokë të re dhe si një moment vendimtar në narrativën kombëtare. Brenda këtij kuadri të përbashkët është zhvilluar një fjalor i pasur, përmes të cilit janë artikulluar interpretimet dhe aspiratat e ndryshme të grupeve të ndryshme shoqërore. Revolucioni, rilindja, rindërtimi dhe modernizimi ishin të gjitha koncepte që përfaqësonin lexime të ndryshme të së kaluarës dhe të së ardhmes. Çlirimi kishte shumë kuptime, por, pasi u arrit një konsensus se kombi ishte çliruar, debatet rreth aspekteve të tjera u moderuan dhe u shndërruan në diskutime konstruktive.⁷²

Rrënjët e konfliktit ndëretnik ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve janë të thella dhe të lidhura me historinë. Gjatë pjesës më të madhe të shek. XX, shqiptarët në Kosovë ishin të ekspozuar ndaj diskriminimit sistematik, dhunës dhe shpërnguljeve të detyruara të orkestruara nga autoritetet jugosllave/serbe.⁷³ Politika e Serbisë nuk kishte për qëllim vetëm ruajtjen e territoreve të pushtuara, por synonte edhe asgjësimin fizik të shqiptarëve dhe zhdukjen e çdo gjurme të trashëgimisë, kulturës dhe historisë së tyre – një përpjekje për zhdukjen e plotë të ekzistencës së tyre. Për rrjedhojë, rezistenca shqiptare kundër Serbisë/Jugosllavisë

⁷¹ Carna Pistan, “Il ruolo di miti e simboli nei processi di nation-building e l’etnicizzazione della memoria nei Balcani occidentali”, *L’allargamento dell’Unione europea e le transizioni costituzionali nei Balcani occidentali*. Una raccolta di lezioni, a cura di Laura Montanari (Napoli: Editoriale scientifica: 2022), 99.

⁷² Michael Kelly, “War and culture: The lessons of post-war France”, *Synergies Royaume-Uni et Irlande*, nr. 1 (2008): 93.

⁷³ Agon Demjaha, *Inter-ethnic realtions in Kosovo*, 182.

<https://intapi.sciendo.com/pdf/10.1515/seeur-2017-0013> (shikuar më 27 qershor 2025).

kishte një karakter të thellë human dhe moral. Formimi i Komitetit “MKK” (Mbrojtja Kombëtare e Kosovës) më 1 maj 1918 nga shqiptarët nën pushtimin serb/jugosllav konkretizoi përkushtimin e tyre për çlirim dhe bashkim kombëtar.⁷⁴ Në Kosovë, për vite me radhë, identiteti jugosllav nuk gjeti rrënjë, ndërsa shqiptarët e përjetonin Kosovën si atdheun e tyre, i cili përfaqësonte thelbin e identitetit të tyre kolektiv.⁷⁵

Pas viteve të rezistencës aktive, të shoqëruar me shumë viktime dhe pasoja të rënda mbi shqiptarët, ata iu kthyen rezistencës paqësore. Megjithatë, pas heqjes së autonomisë së Kosovës, u ndien gjithnjë e më të frustruar nga dështimi i dukshëm i fushatës së tyre të rezistencës pasive, pasi Presidenti jugosllav Slobodan Milošević (Slllobodan Millosheviq), dukej gjithnjë e më i sigurt se nuk do të ndëshkohej për veprimet e tij. Në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998, aktet sporadike të revoltës së armatosur nga shqiptarët hasën në reagime të ashpra nga forcat serbe të sigurisë. Politika serbe me veprimet e saj ndikoi në rritjen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,⁷⁶ ekzistenca e së cilës më pas u përdor si pretekst⁷⁷ për një fushatë serbe shkatërruese kundër fshatrave dhe qyteteve shqiptare gjatë verës së vitit 1998.⁷⁸

Ideja e çlirimit, mbi të cilën u sakrifikuua familja Jashari, u shndërrua në një forcë mobilizuese që forcoi raportet brenda komunitetit shqiptar dhe ndjenjën e nacionalizmit shqiptar.⁷⁹ Përplasja serbo-shqiptare vetëm sa e thelloi më tej këtë ndjenjë dhe konsolidoi idenë e çlirimit. Bota e qytetëruar do të gjendej në krahun e shqiptarëve. Në anën tjetër, në janar të vitit 1999, forcat serbe bënë spastrimin etnik. Nga Kosova u larguan rreth 1 milion shqiptarë.⁸⁰ Në këtë situatë, NATO

⁷⁴ Marenglen Verli, *Shqiptarët përballë sfidave të Historisë*, vëll. I (Tiranë: ASHSH, 2021), 551.

⁷⁵ Mike Medeiros, “Beyond the label: Exploring the role of ethnicity in the Kosovo conflict”, *Studies in Ethnicity and Nationalism*, 21/ 3 (2021): 267.

⁷⁶ Robin M. Williams, *The Wars within: Peoples and States in Conflict* (New Delhi: Manas Publications, 2004), 115.

⁷⁷ James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës* (Tiranë: Onufri 2013), 128.

⁷⁸ Malcolm, *Kosovo, A Short History*, XVII-XVIII; Tim Judah, *Kosovo, What everyone needs to know* (London: Oxford University Press, Inc., 2008), 81.

⁷⁹ Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*, 128.

⁸⁰ Péter Reményi, “Borders, settlement structure and regional issues in the Western Balkans”, në *European Perspective and Tradition – Western Balkans*, (eds.) István Kobolka, Norbert Pap (Budapest: Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Hungary, 2011), 145; William M. Arkin, “Operation Allied Force: The Most Precise

vendosi ta zgjidhte problemin përmes sulmeve ajrore, të cilat kishin për qëllim shkatërrimin e objektivave ushtarakë serbë, duke përfshirë urat dhe aeroportet, ndërsa UÇK-ja zhvillonte operacione tokësore kundër ushtrisë serbe.⁸¹ Në maj 1999, UÇK-ja ndërmoi një ofensivë të rëndësishme, duke siguruar objektiva të përshtatshëm për sulmet ajrore të NATO-s.⁸² Në ato kushte, më 9 qershor, Beogradi u tërhoq dhe kërkoi një armëpushim.⁸³ Kapitullimi i ish-Jugosllavisë, përkatësisht i Serbisë, pas bombardimeve 78-ditore të NATO-s, u përjetua si çlirim kombëtar nga shqiptarët e Kosovës, të cilët kishin bërë luftë të armatosur kundër ish-forcave serbe që nga viti 1998, si dhe rezistencë politike që nga shtypja e autonomisë në vitin 1989.⁸⁴ Në fakt, tërheqja e forcave serbe shënoi fillimin e pavarësisë së Kosovës.⁸⁵ Edhe pas luftës, si shqiptarët e Kosovës, ashtu edhe serbët, e shohin veten si viktimë të agresionit të kryer nga komuniteti tjetër. Si rezultat, armiqësia dhe mosbesimi ndëretnik mbeten të pranishëm.⁸⁶ Politika serbe ndaj çështjes së Kosovës është betonizuar që nga koha e Krizës Lindore dhe nuk ka ndryshuar as deri në fund të shek. XX, as në dekadën e dytë të shek. XXI. Dhuna vazhdon të mbetet pjesë e mendimit kolektiv të elitës politike serbe dhe e kulturës së saj politike.

Interpretimi historik luan një rol qendror në procesin e krijimit dhe të ruajtjes së solidaritetit kombëtar ose etnik, pasi mund të shërbejë për të justifikuar jo vetëm veprimet e së kaluarës, por edhe programet aktuale

Application of Air Power in History”, *War over Kosovo, Politics and Strategy in a Global Age*, (ed.) Andrew J. Bacevich, Eliot A. Cohen (Columbia University Press: 2001), 2.

⁸¹ Reményi, “Borders, settlement strukture”, 155-230; Judah, *Kosovo, What everyone needs to know*, 84-85.

⁸² Klejda Mulaj, “Resisting an Oppressive Regime: The Case of Kosovo Liberation Army”, *Studies in Conflict & Terrorism*, 31, 12 (2008): 113.

⁸³ Reményi, “Borders, settlement strukture”, 155-230; Judah, *Kosovo, What everyone needs to know*, 84-85.

⁸⁴ Matilda Pajo, Donik Sallova, "Legal Framework of the Identity Policy of the International Community in Post-war Kosovo", *A Historical Overview* 4/21 (2023) (shikuar në *Justice in Eastern Europe*. <https://doi.org/10.33327/AJEE-18-6.4-r000408>)

⁸⁵ Prifti, “Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te pavarësia”, 147.

⁸⁶ *Social Cohesion in Kosovo: Context review and entry-points*, korrik 2019, 12. https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/UNDP-FBA-Social-Cohesion-Report-Final_English.pdf (shikuar më 20 qershor 2025).

politike ose ato që synojnë të ardhmen.⁸⁷ Duke hedhur poshtë gjendjen e nacionalizmit të rrethimit të Hoxhës, shumë shqiptarë duket se e kanë zëvendësuar atë me një kthim në rajonalizëm, madje me njëfarë antinacionalizmi që po pengon ndërtimin e një versioni shqiptar të shoqërisë civile. Shqiptarët hynë në epokën postsocialiste me një ndjenjë të dobësuar nacionalizmi dhe, ndryshe nga Zogu e Hoxha, elitat tradicionale dhe jotradicionale nacionaliste shqiptare nuk qenë në gjendje ta drejtonin plotësisht procesin.⁸⁸

Sot bëhen përpjekje të vazhdueshme për ta njollosur sa më shumë Lëvizjen Nacionalçlirimtare në përgjithësi, si në Kosovë, në ish-Jugosllavi, ashtu edhe në Shqipëri. Një punë e tillë, përveçse karakterizohet nga një trajtim i njëanshëm, bëhet me ngut, pa kriterë e kritikë dhe pa dokumentacion të mjaftueshëm proveniencash të ndryshme. Disa individë, të shtyrë nga kureshtja për të njohur të kaluarën tonë, të cilët zhvlerësojnë edhe më shumë këto përpjekje, ofrojnë materiale që, pas një kohe, mezi do të shfrytëzohen edhe si materiale apo si kujtime terreni.⁸⁹

Ka përpjekje për ta përçarë faktorin shqiptar në Ballkan me shpikjen e kombeve të reja. Përpjekja shtetformuese e shqiptarëve të Kosovës gjatë këtyre 25 vjetëve është domethënëse në kuptimin e ndërgjegjësimit kombëtar dhe forcimit të ndjenjave kombëtare të sakrificës dhe të luftës për mbijetesë. Ideja e shtetit të Kosovës nuk ka lindur me synimin për të krijuar një identitet të ri kombëtar për popullin e Kosovës (pra, një komb kosovar), pasi identiteti kombëtar shqiptar i Kosovës ka qenë tashmë i formësuar. Njësia politike nuk e përcakton domosdoshmërisht dhe as nuk e imponon ndryshimin e identitetit kombëtar të një populli, qoftë edhe në rrethana okupimi. Në fakt, përpjekjet e kosovarëve për çlirim, pavarësi dhe ndërtim të shtetit kanë

⁸⁷ Tudi Kernalegenn, "Quando il passato ri tinge di rosso: La socializzazione della storia nazionale e la nazionalizzazione delle lotte sociali in Bretagna e Galizia negli anni '70", *Nazioni e Regioni. Studi e ricerche sulla comunità immaginata* 1 (2013): 141.

⁸⁸ Fischer, *The Development of Albanian Nationalism*.

⁸⁹ Izber Hoti, "Disa aspekte të studimit të historisë së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore", *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, Instituti i Historisë – Tiranë 2014), 97-98.

synuar mbrojtjen, garantimin dhe kultivimin e identitetit të tyre të formuar kombëtar shqiptar, i cili po u cenohej nga Serbia.⁹⁰

Zhvillimet pas pavarësisë në Kosovë kanë ndikuar në identitet. Procesi i shtetndërtimit në Kosovën e quajtur “multietnike” nuk u pasqyrua si një proces i konsolidimit kombëtar të shqiptarëve. Si pasojë, ai devijoi nga etika e kombësisë dhe qeverisja nuk u udhëhoq nga ideale politike kombëtare. Mospërputhja ndërmjet identitetit shtetëror dhe atij kombëtar ka bërë që qytetarët e Kosovës – në këtë rast rreth 90 për qind e popullsisë së saj – të mos e perceptojnë shtetin si mishërim të identitetit të tyre.⁹¹ Praktika tregon se ndërtimi i kombit dhe shtetndërtimi varen nga njëri-tjetri: rritja e identifikimit kombëtar për shkak të fitores në luftë inkurajon investimet në kapacitetet shtetërore, të cilat, nga ana tjetër, ndikojnë në uljen e kostove të konflikteve të brendshme.⁹² Nëse deri më tani kombi shqiptar e ka ruajtur ndjenjën e përbashkësisë mbi bazën e historisë, etnisë, gjakut dhe miteve të përbashkëta – ashtu siç veprojnë të gjitha kombet etnike – tashmë është koha dhe mundësia që, në procesin e komb-konsolidimit, të fuqizohet kohezioni kombëtar,⁹³ i cili është kusht i domosdoshëm për integrimet brendashqiptare në procesin e bashkimit kombëtar. Këto integritime në hapësirën shqiptare duhet t’u paraprijnë integritimeve europiane, në mënyrë që shqiptarët të paraqiten gjithnjë e më shumë para botës si një komb unik.

Përfundime

Duke marrë parasysh zhvillimet politike, kulturore dhe institucionale të Kosovës dhe të gjithë hapësirës shqiptare në shek. XXI, bëhet gjithnjë e më e domosdoshme rishqyrtimi i rolit të çlirimit në ndërtimin dhe konsolidimin e identitetit kombëtar. Çlirimi, i përjetuar jo thjesht si një akt ushtarak, por si një përvojë kolektive e mbijetesës, e dinjitetit dhe e vetëdijes politike, ka lënë gjurmë të pashlyeshme në arkitekturën e kujtesës kombëtare shqiptare. Në këtë kuptim, është imperative që koncepti i çlirimit të trajtohet në mënyrë ndërdisiplinore,

⁹⁰ Donik Sallova, “Çështja e identitetit kosovar”, *Thesis*, nr. 1 (2015): 109.

⁹¹ Pajo, Sallova, “Legal Framework”, 118.

⁹² Nicholas Sambanis, Stergios Skaperdas, William C. Wohlforth, “Nation-Building through War”, *American Political Science Review*, 109, nr. 2 (May 2015): 280.

⁹³ Sallova, “Çështja e identitetit kosovar”, 118.

duke ndërthurur historiografinë kritike me analizat politike dhe antropologjike, me synimin për ta rikonceptuar si një komponent të gjallë të ndërgjegjes kolektive në realitetin bashkëkohor.

Procesi i gjatë i kombformimit dhe shtetndërtimit shqiptar është realizuar përmes një sërë luftërash, përpjekjesh dhe sakrificash të panumërta. Çdo herë që ekzistenca etnike dhe kombëtare ka qenë e rrezikuar, shqiptarët kanë dëshmuar një aftësi të jashtëzakonshme për bashkim dhe rezistencë, duke shtyrë përpara procesin e afirmimit kombëtar. Luftërat e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Kryengritjet e 1912-s, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe Lufta për çlirimin e Kosovës përbëjnë hallka të një zinxhiri historik të pandërprerë, i cili ka mbajtur gjallë idenë e bashkimit dhe të lirisë kombëtare shqiptare.

Ekzistenca e kombit shqiptar është ndërtuar mbi themelet e luftërave të çlirimit dhe të rezistencës ndaj pushtimeve të huaja. Këto përvoja historike kanë krijuar një ndjenjë të fuqishme identitare, e cila është forcuar përmes mbrojtjes së vazhdueshme të gjuhës, kulturës dhe territorit kombëtar. Periudhat e lavdishme të historisë sonë, të kurorezuara me fitore, kanë ushqyer krenarinë kolektive dhe kanë ndihmuar në projektimin e një vizioni optimist për të ardhmen.

Sidoqoftë, forcimi i identitetit kombëtar nuk është një proces i përfunduar. Në një kontekst të globalizimit dhe sfidave të reja rajonale, mbrojtja dhe zhvillimi i këtij identiteti kërkojnë përkushtim të vazhdueshëm, veçanërisht nëpërmjet edukimit, historiografisë kritike dhe forcimit të institucioneve shtetërore. Historiografia shqiptare ka përgjegjësinë që t'i shërbejë jo vetëm afirmimit të arritjeve kombëtare, por edhe një rishqyrtimi kritik të së kaluarës, duke mos lejuar që, në emër të "rivlerësimeve", të zbehet memoria e sakrificës kombëtare.

Për më tepër, është jetike që integrimet brendashqiptare në fushat kulturore, arsimore dhe politike të paraprijnë dhe të ecin paralelisht me integrimet europiane, në mënyrë që shqiptarët, si një komb i vetëm dhe i përbashkuar në diversitetin e tyre, të zënë vendin e merituar në skenën ndërkombëtare. Në këtë prizëm, fuqizimi i kohezionit kombëtar nuk është vetëm një obligim historik, por edhe një domosdoshmëri strategjike për përballimin e sfidave të së ardhmes.

Bibliografi:

- APPIAH, Kwame Anthony. “Rëndësia e vendit tjetër, në mbrojtje të kozmopolizmit”. *AIIS Annual Publication*. Tiranë: AIIS, 2019.
- ARKIN, William M. “Operation Allied Force: The Most Precise Application of Air Power in History”. *War over Kosovo, Politics and Strategy in a Global Age*, (ed.) Andrew J. Bacevich, Eliot A. Cohen. Columbia University Press: 2001.
- ASANI, Skënder. “Skënderbeu i ri, një interpretim ndryshe”. *Studime albanologjike* 17 (2018).
- BARTL, Peter. *Der Westbalkan zwischen spanischer Monarchie und osmanischem Reich. Zur Türkenkriegs-problematik an der Wende vom 16. zum 17. Jahrhundert*. Wiesbaden: Otto Harrassowitz Verlag, 1974.
- BEVIR, Mark. “National Histories: Prospects for Critique and Narrative”. *Journal of the Philosophy of History* 1/2 (2007), <https://escholarship.org/uc/item/8vp2925p>
- BILMEZ, Bülent. “Skanderbeg in the Turkish Historiography: An attempt towards a critical assessment”. *The Living Skanderbeg – The Albanian Hero between Myth and History*, (ed.) Monica Genesin, Joachim Matzinger & Giancarlo Vallone. Hamburg: Verlag Dr. Kovač, 2010.
- BOGDANI, Pjetër. *Letra dhe dokumente nga Arkivi i Kongregatës “de Propaganda Fide” si dhe nga Arkivat Sekrete të Vatikanit*, (ed.) Odette Marquet. Shkodër: At Gjergj Fishta, 1997.
- BOZBORA, Nuray. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*. Tiranë: Dituria, 2002.
- DEMJAHA, Agon. *Inter-ethnic realtions in Kosovo*, 182. <https://intapi.sciendo.com/pdf/10.1515/seeur-2017-0013> (shikuar më 20 qershor 2025).
- DHIMA, Edlira. “Skanderbeg, An emblem in the World Literature”. *European Scientific Journal* January 9, nr. 2 (2013).
- EGRO, Dritan. “Nacionalizmi shqiptar si fenomen historiografik”. *Studime historike*, nr. 1-2 (2008).
- FERAJ, Hysamedin. *Skicë e mendimit politik shqiptar*. Tiranë: Koha, 1998.
- FERMOR, David Sebastian. *Heritage and national identity in post-socialist Albania*. Doctoral thesis (PhD). Manchester Metropolitan University, 2008.

- FISCHER, Bernd. *The Development of Albanian Nationalism*, <https://www.wilsoncenter.org/event/the-development-albanian-nationalism> (shikuar më 20 qershor 2025).
- FRASHËRI, Kristo. "Lidhja e Prizrenit dhe çështja kombëtare". *Studime historike*, nr. 1-2 (1998).
- FRASHËRI, Kristo. *Lidhja e Prizrenit 1878-1881*. Tiranë: Akademia e Shkencave, 2012.
- GIAKOUMIS Kostas & Ilir Kalemaj, "Aleks Buda, Mitet komuniste rreth kombit dhe struktura konceptuale e Muzeut Historik Kombëtar". *Aleks Buda dhe studimet albanologjike*. Përmbledhje e materialeve të konferencës shkencore ndërkombëtare, Elbasan, 20 maj 2016. Tirana: Shpresa Print, 2017.
- GIAKOUMIS, Konstantinos. "Self-Identification by Himarriots, 16 th to 19 th Centuries". *Erytheia. Revista de estudios bizantinos y neogriegos* 37 (2016): 205-246.
- HALLER, Max. "War and National Identity", *Polemos* 6, no. 1-2 (2003). *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I (Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI – vitet '20 të shek. XIX). Redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2002.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. II (Rilindja Kombëtare, vitet '30 të shek. XIX-1912). Redaktor shkencor Kristaq Prifti, grup autorësh, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Tiranë: Toena, 2002).
- HOBBSAWM, Eric J. *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*. Tiranë: Toena, 2012, 67-68.
- HORNE, John. "Defeat and Memory in Modern History". In J. Macleod (ed.) *Defeat and Memory: Cultural Histories of Military Defeat in the Modern Era*. New York: Palgrave Macmillan, 2008.
- HOTI, Izber. "Disa aspekte të studimit të historisë së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore". *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*. Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, Instituti i Historisë – Tiranë 2014.
- HUTCHINSON, John. "Bringing the study of Warfare into theories of nationalism". *Nations and Nationalism* 24, no. 1 (2017).
- HUTCHINSON, John. "Nations as Zones of Conflict". *Nations and Nationalism* 12 (2004) 10.1111/j.1469-8129.2006.002453.x.
- HYSA, Mahmud. *Alamida Shqiptare II*, Studime dhe recensione. Shkup: Logos A, 2000.
- ISMAIL Qemali: "Memorandum sent to Lord Edward Grey". *Discourses of collective identity in Central and Southeast Europe (1770-1945)*:

- Texts and commentaries*. Vol. 3/1, Modernism: The Creation Of Nation States, Edited by Ahmet Ersoy, Maciej Górny and Vangelis Kechriotis. Budapest, New York: Central European University Press 2010.
- JENSEN, Minna Skafté. “Një rrëfenjë heroike: Skënderbeu i Marin Barletit midis krijimtarisë gojore dhe letërsisë”, <http://scanderbeg.dk/Barleti.pdf> (shikuar më 20 qershor 2025).
- JUDAH, Tim. *Kosovo, What everyone needs to know*. London: Oxford University Press, Inc., 2008.
- KABASHI, Artemida. *The Memory of George Castriota-Scanderbeg among the Arbëresh of Italy. A Study on the role of the Diaspora in the Creation of Albanian National Identity*. A Thesis in History, Texas Tech University, 2005.
- KARPAT, Kemal. *Politizimi i Islamit: Rindërtimi i identitetit, i shtetit, i fesë dhe i komunitetit në Shtetin Osman të vonshëm*. Përktheu Urim Poshka. Tiranë: Alsar, 2016.
- KELLY, Michael. “War and culture: The lessons of post-war France”. *Synergies Royaume-Uni et Irlande*, nr. 1 (2008).
- KERNALEGENN, Tudi. “Quando il passato ri tinge di rosso: La socializzazione della storia nazionale e la nazionalizzazione delle lotte sociali in Bretagna e Galizia negli anni '70”. *Nazioni e Regioni. Studi e ricerche sulla comunità immaginata* 1 (2013).
- KOGÄLNICEANU, Mihail. “Speech for the opening of the course on national history”. *Discourses of collective identity in Central and Southeast Europe (1770-1945): texts and commentaries*. Vol. II, National Romanticism - The Formation of National Movements, edited by Balázs Trencsényi and Michal Kopecek. Budapest, New York: Central European University Press, 2007.
- LAJÇI, Lulëzim. “The National - Albanian and Stateforming dimension of Gjergj Kastrioti-Skënderbeg”. *Studia Albanica* 1 (2019).
- LAURENT, Vitalien. “La république de la Chimère et ses appels au pape Grégoire XIII (1577– 1582)”. *Revue des études sud-est européennes* 51 (2013): 27-44.
- LLUKACAJ, Edona. “That “Other” Identity: The Identity Crisis in the Albania of Today”. *International Journal of the Humanities* 7 (2009): 13-20. 10.18848/1447-9508/CGP/v06i09/42530. 224.
- MALCOLM, Noel. *Kosovo, A Short History*. London: Pan Books, 2002.
- MEDEIROS, Mike. “Beyond the label: Exploring the role of ethnicity in the Kosovo conflict”. *Studies in Ethnicity and Nationalism*, 21/ 3 (2021).
- MISHA, Piro. *Arratisja nga burgjet e historisë. Çdo të thotë të jesh shqiptar*. Tiranë: Toena, 2008.

- MULAJ, Klejda. "Resisting an Oppressive Regime: The Case of Kosovo Liberation Army". *Studies in Conflict & Terrorism*, 31, 12 (2008).
- MURZAKU, Thoma. "Traktati i Shën Stefanit dhe rrjedhat e zbatimit të tij për shqiptarët". *Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*, vëll. I, (red.) Aleks Buda, K. Frashëri, A. Kostallari. Tiranë: Akademia e Shkencave, 1979.
- O'BRIEN, Tara Ashley. *Manufacturing homogeneity in the Modern Albanian Nation* (Dissertation). Budapest: Central European University Budapest, 2008.
- PAJO, Matilda & Donik Sallova, "Legal Framework of the Identity Policy of the International Community in Post-war Kosovo". *A Historical Overview* 4/21 (2023) (shikuar në *Justice in Eastern Europe*. <https://doi.org/10.33327/AJEE-18-6.4-r000408>)
- PETTIFER, James. *Ushtria Çlirimtare e Kosovës*. Tiranë: Onufri 2013.
- PISTAN, Carna. "Il ruolo di miti e simboli nei processi di nation-building e l'etnicizzazione della memoria nei Balcani occidentali". *L'allargamento dell'Unione europea e le transizioni costituzionali nei Balcani occidentali*. Una raccolta di lezioni, a cura di Laura Montanari. Napoli: Editoriale scientifica: 2022.
- PRIFTI, Kristaq. "Nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit te pavarësia e Shqipërisë dhe e Kosovës". *Studime historike*, nr. 1-2 (2008).
- PRIFTI, Kristaq. *Shkrime historike për Rilindjen Kombëtare*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2016.
- REMÉNYI, Péter. "Borders, settlement structure and regional issues in the Western Balkans". *European Perspective and Tradition - Western Balkans*, (eds.) István Kobolka, Norbert Pap. Budapest: Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Hungary, 2011.
- SALLOVA, Donik. "Çështja e identitetit kosovar", *Thesis*, nr. 1 (2015).
- SAMBANIS, Nicholas & Stergios Skaperdas, William C. Wohlforth. "Nation-Building through War". *American Political Science Review*, 109, nr. 2 (May 2015).
- SCHMITT, Oliver Jens. *Skënderbeu*. Tiranë, Fjala, 2014.
- SMITH, Anthony D. *Nationalism and Modernism, A critical survey of recent theories of nations and nationalism*. London and New York: Routledge, 1998.
- SMITH, Anthony D. S. *Nationalism in the Twentieth Century*. New York: New York University Press, 1979.
- Social Cohesion in Kosovo: Context review and entry-points*, korrik 2019, 12. https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/ks/UNDP-FBA-Social-Cohesion-Report-Final_English.pdf (shikuar më 20 qershor 2025).

- STOESSINGER, John G. *Përse kombet shkojnë në luftë*. Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, 2015.
- SULSTAROVA, Enis. *Nacionalizmi: Kombi, shteti dhe politika në epokën moderne*. Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2022.
- SHKËLZENI, Nirvana. "How and why is a Theory of ideology of importance for media representations of National Identity: Albanian Identity during the Communist Regime". *Mediterranean Journal of Social Sciences*, vol. 5 no. 2 (January 2014). MCSER Publishing, Rome-Italy.
- SHPUZA, Gazmend. "Kuvendi themelues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në xhaminë Bajrak (15 qershor 1878)". *Univers*, revistë shkencore dhe kulturore, Instituti shqiptar i mendimit dhe qytetërimit islam, Nr. 11 (2009).
- SHPUZA, Gazmend. *Në vazhdën e gjurmimeve... .* Tiranë: Toena, 1997.
- VERLI, Marenglen. "Antifashizmi, alternativa e perspektivës për kombin shqiptar". *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*. Prishtinë: Instituti i Historisë "Ali Hadri" – Prishtinë, Instituti i Historisë – Tiranë 2014.
- VERLI, Marenglen. "Nga Lidhja e Prizrenit te pavarësia e Kosovës". *Studime historike*, nr. 3-4 (2007).
- VERLI, Marenglen. *Shqiptarët përballë sfidave të Historisë*, vëll. I. Tiranë: ASHSH, 2021.
- VICKERS, Miranda. *Between Serb and Albanian: A History of Kosovo*. New York: Columbia University Press, 1998.
- VICKERS, Miranda. *The Albanians – A Modern History*. London: I. B. Tauris Publishers, 1999.
- VUKA, Denis. *Ideology and Educational Media: Albania's Third Grade National History Textbooks during the Period of Self-Isolation (1978-1984)*. (Temë disertacioni). Freien Universität Berlin: 2018.
- ВУКОИЧИЋ, Јелена. "Рат и национални идентитет", *Политеиа* бр. 3, Бања Лука, јун 2012 (Jelena Vukočić, "Rat i nacionalni identitet", *Politeia* br. 3, Banja Luka, jun 2012).
- WILLIAMS, Robin M. *The Wars within: Peoples and States in Conflict*. New Delhi: Manas Publications, 2004.
- XHARO, Kristaq. "Kombi, lufta, dhe dilemat e fuqisë – Refleksion në 75 vjetorin e Çlirimit". *Studime për historinë ushtarake*, vëll. 12, nr. 1 (2019).
- ZHELYAZKOVA, Antonina. *Albania and the Albanian Identities*. Sofia: IMIR, 2000.

PROF. ASOC. DR. ETHEM ÇEKU
University of Prishtina “Hasan Prishtina”
ethem.cek@uni-pr.edu

S u m m a r y

THE IMPACT OF LIBERATION ON NATIONAL IDENTITY: SCIENTIFIC
ANALYSIS AND FUTURE PERSPECTIVES

This article provides a comprehensive and interdisciplinary analysis of the role of liberation wars in the construction, affirmation, and consolidation of Albanian national identity from the early modern period to the contemporary era. Drawing on critical historiography, theories of nationalism, and the concept of collective memory, it argues that acts of liberation—whether against the Ottoman Empire in the case of Albania, or against Serbian rule in the case of Kosovo—served not only as political or military milestones, but as deeply symbolic processes through which national self-awareness was articulated and institutionalized. The study pays particular attention to pivotal episodes such as the League of Prizren, the National Liberation War, and the Kosovo War, examining their impact on shaping historical consciousness and a sense of shared destiny among Albanians. It highlights how state narratives, educational systems, and official historiography have selectively transmitted the memory of war and liberation to foster national unity and legitimacy. Through a comparative and discursive methodology that incorporates both primary sources and critical secondary literature, the article demonstrates that the concept of liberation in Albanian history extends beyond the end of foreign domination—it encompasses the emergence of a national ethos that legitimizes the right to self-determination, political independence, and territorial integrity. The paper concludes by suggesting that liberation narratives, though often politicized, continue to play a decisive role in contemporary debates on identity, sovereignty, and regional stability in the Western Balkans. The article contributes to a broader understanding of how wars of liberation become foundational myths in nation-building processes and remain central to national memory in post-conflict societies.

Key words: Identiteti kombëtar shqiptar, luftërat çlirimtare, kujtesa historike, historiografia shqiptare, nacionalizmi modern, procesi i kombformimit, shtetndërtimi në Kosovë

